



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 383/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Shtime paraqitur kundër subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), për shkak të vendosjes së posterave në objektin publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1100 (njëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 29.10.2013, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se Partia e Drejtësisë (PD) më datë 28.10.2013 në orën 10:30 ka vendosur postera të kandidatëve për kuvend komunal të Shtimes në hapësirat dhe në objektin publik shkollën fillore “Emin Duraku” në Shtime me këto veprime janë bërë shkelje të nenit 33 pika b e LZP-se dhe neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tre fotografi si dëshmi, për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PD, me datën 30.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013 deri në ora 12:00. PZAP-i pranoi në afatin e paraparë përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PD, lidhur me ankesën A.nr 383/2, të paraqitur nga subjekti politik LVV, ku theksohet se posterat e PD ishin vendosur gjatë takimit me qytetar si lloj njoftimi pastaj janë larguar këta postera. Ata shtojnë se kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që degët e tyre të mos shkelin rregullat zgjedhore dhe ata janë të vetëdijesuar për respektimin e këtyre rregullave. Sipas tyre ata janë të gatshëm të marrin të gjitha përgjegjësitë në momentin kur vërehet se aktivistët e tyre kanë bërë shkelje por nuk do të merren me subjektet tjera të cilat dëshirojnë të dëmtojnë procesin zgjedhor.

PD i propozon PZAP-it që të hedhë poshtë pretendimet e LVV-së

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sepse me datën 29.10.2013, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se Partia e Drejtësisë (PD) më datë 28.10.2013 në orën 10:30 ka vendosur postera të kandidatëve për kuvend komunal të Shtimes në hapësirat dhe në objektin publik shkollën fillore "Emin Duraku" në Shtime me këto veprime janë bërë shkelje të nenit 33 pika b e LZP-se dhe neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterat e kandidatit për kryetar komune dhe të kandidatit për kuvend komunal nga radhët e PD-së, kanë qenë të vendosura në objektin publik respektivisht në shkollë fillore të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se PD, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune dhe kandidatit për kuvend komunal në Shtime kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PD, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PD-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës dhe atij të kuvendit komunal nga radhët e PD-së janë vendosur në rrethojë të objektit publik, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PD-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë

të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në bazë të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 383/2013 më datën 01.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*